



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.807/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllagjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Malsore Cakiqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Malsore Cakiqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, në Vendvotimin nr. 0319E/02D, 0301X/04D, 0311E/03D në Glllogocë.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Malsore Cakiqi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimin nr. 0319E/ 02D, në Zabel të Ulët në Glllogoc, kanë deklaruar se kanë votuar dy votues për subjektin politik NISMA për Kosovën me nr. 31 dhe për kandidatin e këtij subjekti me nr.20, mirëpo pas publikimit të rezultateve nga KQZ-ja nuk ka figuruar asnjë votë në atë vendvotim, poashtu në vendvotimin nr. 0301X/04D në SHFM “Halil Bajraktari” në Glllogoc kanë deklaruar se kanë votuar pesë (5) persona për subjektin politik NISMA për Kosovën me nr. 31 dhe për kandidatin e këtij subjekti me nr.20, mirëpo pas publikimit të rezultateve figuron vetëm 1 votë dhe në vendvotimin nr. 0311E/03D në Fushticë të Epërme, kanë deklaruar se kanë votuar dymbëdhjetë (12) persona për subjektin politik NISMA për Kosovën me nr. 31, ndërsa pas publikimit të rezultateve figurojnë vetëm 4 vota dhe me këtë rast dyshon se ato vota i janë bartur ndonjë kandidati tjetër.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur deklaratat e votuesëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) vendvotimin e cekur në pikën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura miratoj apelin si të bazuar në mbështetje të nenit 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.807/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.